REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA-VLADA-GOVERMMENT
MINISTRIA E FINANCAVE, PUNËS DHE TRANSFEREVE - MINISTRAVO FINANSIJA, TRANSFERA
MINISTRY OF FINANCE, LABOUR AND TRANSFERS
01/02 1619-3/24/25 18.11.25
PRISHTINË/PRIŠTINA/PRISTINA

# Republika e Kosovës
## Republika Kosova - Republic of Kosovo
### *Qeveria –Vlada - Government*

*Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve – Ministarsvo za Finansije, Rada i Transfera – Ministry of Finance, Labour and Transfers*

**Nr.** 55-5/24/25
**Datë: 18.11.2025**

Në mbështetje të nenit 11, paragrafit 1.5 të Ligjit Nr.08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, me qëllim të zbatimit të Vendimit Nr.13/19 të datës 14.07.2021 të Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me Pakon e Ringjalljes Ekonomike, si dhe bazuar në Vendimin 09/273 të datës 31.10.2025 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve nxjerr këtë:

**VENDIM** Nr: 55-5/24/25

**për plotësimin dhe ndryshimin e Vendimit Nr.55/2021, i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin Nr.55-1/2021, Vendimin Nr.55-2/2021, Vendimin Nr.55-2/2022, Vendimin Nr.55-3/22/23 dhe Vendimin 55-4/2024**

1. Ndryshohet paragrafi 1 i Vendimit Nr.55/2021, i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin Nr.55-1/2021, Vendimin Nr.55-2/2021, Vendimin Nr.55-2/2022, Vendimin Nr.55-3/22/23 dhe Vendimin 55-4/2024, ashtu që i njëjti riformulohet si në vijim:

   1.1. Për familjet që kanë deri në dy (2) fëmijë të moshës zero deri në gjashtëmbëdhjetë (0-16) vjeç, mbështetja do të jetë tridhjetë euro në muaj (30.00 €) për secilin fëmijë; dhe

   1.2. Për familjet që kanë tre (3) apo më shumë fëmijë të moshës zero deri në gjashtëmbëdhjetë (0-16) vjeç, mbështetja do të jetë dyzetë e pesë euro në muaj (45.00 €) për secilin fëmijë

2. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**Hekuran Murati**

Ministër i Financave, Punës dhe Transfereve

Vendimi i'u dërgohet:
- Kabinetit të Ministrit;
- Zëvendës Ministrave;

- Sekretarit të Përgjithshëm; dhe
- Arkivit të MFPT-së